



## Broshurë informative mbi Parlamentin

**KODI I SJELLJES,  
PRAKTIKAT,  
MODELET DHE  
STANDARDET  
E INTEGRITETIT  
PARLAMENTAR**



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR



## Realizoi

Instituti i Studimeve Politike (ISP)

Web: [www.isp.com.al](http://www.isp.com.al)

E-mail: [contactaips@isp.com.al](mailto:contactaips@isp.com.al)

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89, K.3, Ap. 16, Tiranë

Shtator, 2023



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinonet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

## PËRMBAJTJA

---

### Hyrje

### Parlamenti dhe rëndësia e Kodit të Sjelljes

### Parimet dhe vlerat themelore të etikës parlamentare

### Rregullat kryesore të Kodit të Sjelljes

- Sjellja në Kuvend
- Votimi për të tretët
- Konflikti i interesit
- Kufizime gjatë ushtrimit të mandatit
- Veprimtaria joparlamentare e lejuar e deputetit
- Kufizimet pas përfundimit të mandatit
- Lobimi
- Dhuratat dhe përfitimet e tjera të ngjashme
- Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë
- Marrëdhëniet me stafin e parlamentit

### Zbatimi i Kodit të Sjelljes dhe vlerësimi i zbatimit të tij

### Aneks me informacione

### Bibliografia

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

## AKRONIME DHE SHKURTIME

APKE	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
BE	Bashkimi Evropian
BK	Byroja e Kuvendit
CPA	Commonwealth Parliamentary Association
GOPAC	Organizata Globale e Parlamentarëve kundër Korrupsionit
GP	Grupet parlamentare
GRECO	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
IPU	Unioni Ndërparlamentar
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave
KK	Konferenca e Kryetarëve
Kodi i Sjelljes	Kodi i Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
KSH	Kuvendi i Shqipërisë
Ligji 9367/2005	Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" të ndryshuar".
MB	Mbretëria e Bashkuar
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TI	Lëvizja "Transparenca Ndërkombëtare"
WDF	Westminster Foundation for Democracy

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

## HYRJE

Në sondazhin mbi besimin në qeverisje 2022 parlamenti është institucioni me besimin më të ulët publik (33%) ndjekur nga prokuroria (35.2%) dhe gjykatat (36.2%), duke u krahasuar me partitë politike, të cilat duke mos qenë institucion shtetëror dhe i identifikueshëm ka edhe perceptim më kompleks (29%). Ky është një prej anketimeve më të qëndrueshme në metodologji dhe në periodicitet, ndërkohë që në sondazhe të tjera profesionale që lidhen me problematika të përfaqësimit rezultojnë të dhëna kritike për cilësinë parlamentare, nivelin e korrupsionit, integritetin e deputetëve dhe hendekun e thellë midis mandatit, pritshmërive publike dhe rezultateve konkrete të aktivitetit të tyre ligjvënës dhe politik. Megjithëse sondazhet dhe anketimet janë perceptime dhe si të tilla, tregojnë trende jo 100% matje faktike të gjetjes dhe problematikave, sondazhet dhe anketimet ofrojnë të dhëna serioze për të kuptuar trendet e zhvillimit dhe për të korriguar politika vendimmarrëse.

Ky nivel kritik i besimit tek parlamenti nuk është një trend kritik vetëm për Shqipërinë, por në tërësi, një trend kritik për parlamentarizmin në tërësi, përfshirë vendet e rajonit. Kriza e demokracisë dhe e përfaqësimit reflektohet së pari tek parlamenti dhe partitë politike dhe më pas në institucionet e tjera, tipari i rritjes së natyrës autoritariste të regjimeve në disa vende, përfshirë rajonin dhe Shqipërinë, ndikon në dobësimin e parlamentarizmit dhe rivalitetin midis mbështetjes për udhëheqësin kryesor politik (president ose kryeministër, në varësi nga sistemi qeverisës) dhe parlamentit, si produkt indirekt institucional i tij/tyre.


Kurba e besimit të parlamenti 2015-2022 në vetvete përputhet me dy zhvillime, kuotën më të ulët të besimit në legjislaturën e dominuar nga debati mbi disa deputetë të inkriminuar, shkak që çoi më 2015 në miratimin e ligjit të dekriminalizimit, si dhe kuota e dytë më kritike kur opozita dorëzoi mandatet parlamentare dhe bojkotoi sistemin përfaqësues më 2019-2020. Vitet e fundit ka pasur edhe praktika të deklarimeve "non grata", hetime për korrupsion e dorëheqje të zyrtarëve të lartë, përfshirë deputetë, si dhe fenomene të tjera, të ndryshme nga praktika e deritanishme e tranzicionit. Impakti i tyre do kohë të matet, por në tërësi ekziston një presion e konsensus publik mbi nevojën e reformimit të politikës, duke nënkuptuar, reformimin e mënyrës së bërjes së politikës, të vendimmarrjes, të sjelljes së aktorëve politikë, të transparencës dhe të llogaridhënies së tyre. Premtimi për dhënie fund të pandëshkueshmërisë mbetet slogan përderisa reformat antikorrupsion nuk do të sigurojnë standarde të njëjta hetimi edhe për zyrtarët e lartë me imunitet politik, siç janë deputetët, ministrat dhe zyrtarët e zgjedhur ose të emëruar edhe nga parlamenti.

Të dhënat e tabelës dhe në tërësi raportet kritike për nivelin e parlamentarizmit, cilësinë e përfaqësimit, korrupsionin me natyrë politike, dekriminalizimin, konfliktualitetin politik,



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

etikën e munguar parlamentare, ligjërimin denigrues, etj, lidhen me standardet e integritetit, të cilat ndonëse nuk janë standarde 100% ligjore, janë baza e standardeve etike, e kodeve të sjelljes dhe të integritetit në përfaqësim e vendimmarrje.



Nevoja për një parlament të hapur dhe llogaridhënës, me standarde të larta integriteti dhe që zbaton praktikën e mira të Kodit të Sjelljes nxiti Institutin e Studimeve Politike (ISP) të angazhohet në promovimin e këtyre parimeve, monitorimin e praktikave dhe aktivitetit parlamentar dhe investimin publik e profesional në projektin “*A parliament with integrity: Code of Conduct, transparency and accountability*” të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Kjo broshurë informative është produkti i parë i projektit. Synimi kryesor është sensibilizimi i deputetëve, grupeve parlamentare dhe strukturave të Kuvendit mbi rëndësinë e standardeve të etikës, të Kodit të Sjelljes dhe të integritetit në përfaqësim dhe vendimmarrje. Broshura është hartuar nga ekipi i ekspertëve të ISP-së, me përvojë të gjatë në monitorimin dhe ndjekjen e problematikave që lidhen me jetën parlamentare në Shqipëri. Një numër botimesh profesionale, - raporte periodike apo anketime, broshura dhe studime, gjenden në aneksin përmbyllës të broshurës dhe janë me akses të lirë për çdo të interesuar.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) falënderon ambasadën e SHBA në Tiranë për besimin dhe mbështetjen, si dhe të gjithë ekspertët e angazhuar në kuadër të projektit. ISP falënderon edhe Kuvendin, i cili përmes zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm ka shprehur vullnetin për bashkëpunim në jetësimin e projektit.

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

## PARLAMENTI DHE RËNDËSIA E KODIT TË SJELLJES

Parlamenti, si organi më i lartë përfaqësues dhe mbartësi i sovranitetit të popullit, është institucioni kyç në sistemet demokratike të qeverisjes, status ky që kërkon vendosjen e standardeve të larta të integritetit dhe llogaridhënies institucionale (për parlamentarët). Nga parlamentarët pritet që të respektojnë standardet më të larta të etikës dhe sjelljes pasi perceptimet negative të deputetëve mund të kenë impakt të rëndësishëm në respektin që publiku ka për institucionin parlamentar në përgjithësi.

Parlamenti ka një rol thelbësor në frenimin e korrupsionit dhe krijimin e mjediseve që minimizojnë mundësitë dhe hapësirat për veprime korruptive. Një ligjvënës është përgjegjës për sigurimin e një kornize legjislative efektive dhe të favorshme për antikorrupsion, por funksioni themelor i një parlamenti në këtë drejtim dhe në mbikëqyrjen e institucioneve publike, që i zbatojnë ato, nuk mund të jetë efektiv nëse vetë ligjvënësit nuk i kanë të qarta rregullat e sjelljes në veprimtarinë parlamentare. Shumë vende kanë vendosur standarde gjithëpërfshirëse etike për të garantuar ushtrimin në mënyrë etike të funksioneve nga parlamentarët. Këto standarde të cilat përfshihen në të ashtuquajturin Kod Sjelljeje përfshijnë rregulla specifike duke detajuar kërkesat për t'u përmbushur si dhe një autoritet përgjegjës (rregullator) për t'i zbatuar këto rregulla.

Korrupsioni perceptohet si një problem serioz për çdo shoqëri, pasi në të gjitha format e tij ai bëhet pengesë për zhvillim. Përballë korrupsionit në rritje dhe sjelljeve të tjera të pahijshme, kodet parlamentare të sjelljes vendosin standarde për sjellje të pranueshme duke kontribuar në profesionalizmin e politikës dhe rritjen e besimit të publikut tek parlamenti. Në këtë aspekt, është i rëndësishëm niveli i besimit që ka publiku si ndaj deputetit si individ, ashtu edhe ndaj Kuvendit si institucion të cilin e përfaqëson.

Motivi kryesor në miratimin e kodeve të sjelljes është në drejtim të ruajtjes dhe rritjes së besimit ndaj parlamentit dhe ndaj demokracisë përfaqësuese. Aktualisht korniza ligjore në Shqipëri për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përbëhet nga ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, ligji për deklarimin e pasurisë dhe ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve. Pjesë e kornizës ligjore dhe e politikave për parandalimin dhe zvogëlimin e korrupsionit, është edhe Kodi i Sjelljes për parlamentarët, anëtarët e qeverisë, funksionarët publikë të zgjedhur, si dhe një Kod i veçantë për nëpunësit e administratës publike.

Etika parlamentare është hapi i parë i komunikimit institucional dhe nevojë institucionale për të përmirësuar imazhin e institucionit më të lartë ligjvënës dhe politikës në publik. Integriteti institucional dhe etika parlamentare janë indikatorët e një parlamenti

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Ilogaridhënës<sup>1</sup> dhe si të tillë janë parashikuar ndër vlerat themelore nga të cilat udhëhiqet Kuvendi i RSH-së në përmbushje të vizionit dhe misionit të tij<sup>2</sup>.

Sipas Transparency International një kod sjelljeje është një deklaratë parimesh dhe vlerash, që parashikon pritshmëritë dhe standardet për mënyrën se si një organizatë, qeveri, organ, kompani, grup i lidhur ose individ do të sillet, duke përfshirë nivelet minimale të pajtueshmërisë dhe masat disiplinore për organizatën, stafin e saj dhe vullnetarët<sup>3</sup> dhe si i tillë, ai duhet t'i përcaktojë në mënyrë të qartë, efektive dhe të drejtë rregullat e sjelljes.

Referuar raporteve të organizmave ndërkombëtarë tre komponentët kryesorë të një Kodi Sjelljeje janë: parimet etike të cilave duhet t'u përmbahet çdo parlamentar; rregullat të cilat përcaktojnë sjelljen e lejueshme të parlamentarit, konkretisht dispozitat në lidhje me konfliktin e interesit, deklarimin e pasurisë, dhuratat dhe mikpritjen, kufizimet pas përfundimit të ushtrimit të mandatit, gjuhën parlamentare, lobimin, veprimtaritë joparlamentare të lejueshme etj., si dhe mekanizmat për zbatimin e rregullave dhe aplikimin e masave ndëshkuese<sup>4</sup>.

## PARIMET DHE VLERAT THEMELORE TË ETIKËS PARLAMENTARE

Parimet dhe vlerat themelore të etikës parlamentare sigurojnë bazën nga e cila ndërtohen, jo vetëm rregullat të cilat përcaktojnë sjelljen e lejueshme të parlamentarit, por edhe vullneti politik për të vendosur standardet e sjelljes<sup>5</sup>. Megjithëse ekzistojnë disa standarde të caktuara ndërkombëtare çdo parlament vendos vetë për parimet dhe vlerat themelore të etikës parlamentare. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar pothuajse të gjitha kodet e sjelljes për funksionarët publikë fillojnë me shtatë parimet e jetës publike, të përpunuara nga Komiteti për Standardet në Jetën Publike, të cilat janë: vetëmohimi, integriteti, objektiviteti, transparenca, llogaridhënia, lidhshmëria<sup>6</sup>. Kodi i sjelljes i Lituaniës

<sup>1</sup> Shih: Inter-parliamentary Union 2022, fq. 243 në linkun

Indicators for democratic parliaments. <https://www.ipu.org/impact/democracy-and-strong-parliaments/ipu-standards/indicators-democratic-parliaments> (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023).

<sup>2</sup> Shih: Plani Strategjik i Kuvendit 2020-2025 miratuar me vendimin nr. 56/2021 të Kuvendit, fq. 7 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023).

<sup>3</sup> Shih Transparency International, 2009. The anticorruption plain language guide. <https://www.transparency.org/en/publications/the-anti-corruption-plain-language-guide> (Aksesuar për herë të fundit më 01.09.2023).

<sup>4</sup> Shih: Parliamentary Integrity: A Resource for Reformers, fq. 48 në linkun [https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576_2.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023)

Shih: Transparency International, 2022, Codes of conduct for parliamentarians, fq. 9 (Aksesuar për herë të fundit më 01.09.2023).

Shih: Handbook on parliamentary ethics and conduct a guide for parliamentarians, WDF & GOPAC [https://gpgovernance.net/wp-content/uploads/2021/02/HandbookonParliamentaryEthicsandConductFinal2010\\_EN-1.pdf](https://gpgovernance.net/wp-content/uploads/2021/02/HandbookonParliamentaryEthicsandConductFinal2010_EN-1.pdf) fq. 20-34 (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023).

<sup>5</sup> Shih: Handbook on parliamentary ethics and conduct a guide for parliamentarians, WDF & GOPAC [https://gpgovernance.net/wp-content/uploads/2021/02/HandbookonParliamentaryEthicsandConductFinal2010\\_EN-1.pdf](https://gpgovernance.net/wp-content/uploads/2021/02/HandbookonParliamentaryEthicsandConductFinal2010_EN-1.pdf) fq. 4 cit. (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023).


<sup>6</sup> Shih: Committee on Standards in Public Life, Guidance: The Seven Principles of Public Life 31 maj 1995 <https://www.gov.uk/government/publications/the-7-principles-of-public-life/the-7-principles-of-public-life--2>



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

për politikanët përcakton parimet e sjelljes në vijim: respekti ndaj personit si individ dhe shtetit, drejtësia, ndershmëria, transparenca dhe publiciteti, mirësjellja, të qenët shembullor, vetëmohimi, paanshmëria dhe përgjegjësia.<sup>7</sup> Ndërsa Kodi i Mirësjelljes së Kosovës parashikon parimet vijuese: vetëmohim, integritet moral, objektivitet, përgjegjësi, sinqeritet, ndershmëri, leadership<sup>8</sup>.

Në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare Kodi i Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë (në vijim Kodi i Sjelljes) parashikon këto parime nga të cilat udhëhiqen ligjvënësit: vetëmohim, integritet, leadership, transparenca, ligjshmëri, ndershmëri, objektivitet, përgjegjshmëri, llogaridhënie<sup>9</sup>. Të njëjtat vlera sanksionohen edhe në Planin Strategjik të Kuvendit: përfaqësim, kushtetutshmëri dhe ligjshmëri, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje barazi dhe mosdiskriminim transparenca, integritet dhe etikë, profesionalizëm dhe kompetencë, paanësi politike<sup>10</sup>.



(Aksesuar për herë të fundit më 04.09.2023).

<sup>7</sup> Shih: Lituania, Ligji për miratim, hyrje në fuqi dhe zbatim të Kodit të sjelljes për politikanët shtetërorë, neni 4 (19 shtator 2006 nr. X-816) në linkun <https://e-seimas.lrs.lt/portal/legalAct/lt/TAD/TAIS.287040>  
<https://e-seimas.lrs.lt/portal/legalAct/lt/TAD/TAIS.287040>

(Aksesuar për herë të fundit më 04.09.2023).

<sup>8</sup> Shih: Ligji nr. 03/I-111 "Për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit", kreu VII Kodi i Mirësjelljes dhe Konflikti i Interesave, neni 39 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2680> (Aksesuar për herë të fundit më 22.09.2023).

<sup>9</sup> Neni 3 - KSDKRSH

<sup>10</sup> Shih: Plani Strategjik i Kuvendit 2020-2025 miratuar me vendimin nr. 56/2021 të Kuvendit, fq. 7-8 në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/20211025114206vendimi%20dhe%20plani%20strategjik.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

## RREGULLAT E SJELLJES<sup>11</sup>

Në respektim të standardeve ndërkombëtare, Kodi i Sjelljes rendit një sërë rregullash të cilat mbulojnë të gjitha aspektet, që lidhen me integritetin e parlamentarit dhe që i referohen kornizës ligjore vijuese:


- Kushtetutës, Rregullores së Kuvendit dhe ligjit nr. 8550/1999 "Statusi i Deputetit" të ndryshuar<sup>11</sup>;
- Ligjeve që rregullojnë aspektet e veçanta të punës së deputetëve si funksionarë publikë, përkatësisht ligji nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" të ndryshuar<sup>11</sup>, ligji nr. **9049/2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" të ndryshuar<sup>11</sup>**, ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" etj;
- Ligjeve të tjera siç janë ligji nr. 10.221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" të ndryshuar<sup>11</sup>, ligji nr. 10/2023 "Për informacionin e klasifikuar", ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" të ndryshuar<sup>11</sup> etj.



<sup>11</sup> Shënim: Në respektim të parimeve dhe standardeve të vendosura nga organizmat ndërkombëtarë rregullat e KSDKRSH-së nuk lidhen dhe as ndërthuren me procedura që trajtojnë të drejta ose kufizime të të drejtave në funksion të imunitetit parlamentar, veçanërisht atij penal. KSDKRSH përcakton qartësisht se nuk kufizon të drejtat dhe imunitetin penal të deputetit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe Rregullorja e Kuvendit. Shih: Parliamentary Integrity: A Resource for Reformers, OSCE 2022, fq. 26 në linkun [https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576_2.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023) dhe Transparency International, Codes of conduct for parliamentarians 2022 fq. 6 cit. <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/kproducts/Code-of-Conduct-for-Parliamentarians-2022.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 03.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

## INTERESAT E MUNDSHME TË DEPUTETËVE BAZUAR NË SONDAZHE



## SJELLJA NË KUVEND<sup>12</sup>

Kodi i Sjelljes përcakton një sërë rregullash të sjelljes etike, të cilat përfshijnë etikën në komunikim, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, respektimin e mendimit ndryshe, evitimin e çdo situatë të konfliktit verbal dhe fizik, deri tek detyrimi për respektimin e Kodit të veshjes dhe evitimin e përdorimit të telefonisë gjatë seancave dhe mbledhjeve të organeve të Kuvendit.

Kuvendi ka juridiksionin ekskluziv të shqyrtimit dhe ndëshkimit disiplinor të rasteve kur deputetët, me anë të fjalës, sjelljeve dhe veprimeve të tyre cenojnë autoritetin e Kuvendit dhe ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të deputetëve të tjerë<sup>13</sup>. Autoriteti i Kuvendit dhe organeve të tij, për respektimin e rregullave të etikës në komunikim, shtrihet në të gjitha veprimtaritë parlamentare<sup>14</sup> ku deputeti merr pjesë si dhe në të gjitha

<sup>12</sup> Neni 6, Kodi i Sjelljes në Kuvendin e RSH

<sup>13</sup> Referuar neneve 64-65/1 të Rregullores së Kuvendit masat disiplinore, që aplikohen për sjellje të pahijshme janë: tërheqje vëmendjeje, vërejtje, heqje e së drejtës së fjalës gjatë seancës/mbledhjes së organit të Kuvendit, përjashtim nga seanca plenare/mbledhja e organit të Kuvendit, përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/organet e Kuvendit deri në 10 ditë.

<sup>14</sup> Për sa i përket shtrirjes së autoritetit të Kuvendit një dispozitë e posaçme (neni 40) përcakton llojet dhe kufijtë e veprimtarisë parlamentare. Sipas kësaj dispozite *Deputetët janë në veprimtari parlamentare kur ata marrin pjesë në seancë plenare, në mbledhjet e komisioneve/nënkomisioneve ose të këshillave, në veprimtari brenda ose jashtë vendit ose veprimtari në zonat*

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

ambientet e Kuvendit<sup>15</sup>. Referuar rregullave, ky autoritet shtrihet edhe ndaj Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejtuesve/përfaqësuesve të institucioneve kushtetuese apo të krijuara me ligj si dhe ndaj personave të tjerë të pranishëm në Kuvend.

Është praktikë e zakonshme që parlamentet të ndalojnë përdorimin e gjuhës fyese dhe diskriminuese.

- Në Letoni gjatë fjalimeve të tyre parlamentarët *duhet të shmangin çdo fjalë, gjest apo veprim tjetër, që mund të jetë fyese dhe i papajtueshëm me respektin për parlamentin*<sup>16</sup>; në Itali rregullat e procedurës ndalojnë në mënyrë eksplicite përdorimin e fjalëve të pahijshme apo fyese, thirrjet për dhunë, kërcënimet apo abuzimet<sup>17</sup>;
- Në Kosovë ndalohet *përdorimi i gjuhës joparlamentare apo i veprimeve që prishin rregullin e punës në seancë apo nxisin ose ushtrojnë dhunë*<sup>18</sup>;
- Në Maqedoninë e Veriut deputetit *i ndalohet t'i ndërpresë fjalën folësit, të hedhë fjalë nga vendi ose në cilëndo qoftë mënyrë tjetër të prishë rrjedhën e seancës dhe të përdorë fjalë fyese, fraza, shprehje ose gjestikulacione me të cilat mund të fyhen ose përçmohen deputetët e tjerë ose bartësit e funksioneve publike, të nxisë urrejtje, intolerancë dhe dhunë në bazë personale, ideologjike, fetare, nacionale, gjinore dhe racore*<sup>19</sup>.

Në një demokraci, parlamenti është forumi esencial për debate politike, është vendi i ballafaqimit politik dhe shprehjes së mendimeve e opinionëve të ndryshme pluraliste, i shprehjes së diversiteteve dhe alternativave politike prandaj deputeti duhet të shfaqë standardet më të larta të sjelljes së qytetëruar, dinjitoze dhe të etikës parlamentare korrekte dhe të jetë model komunikimi dhe vlerësimi. Zbatimi dhe respektimi i rregullave të etikës dëshmon integritetin personal të deputetit aq sa edhe mungesa e tyre cenon jo vetëm punimet parlamentare, por edhe besimin e publikut në institucionin e Parlamentit.

---

zgjedhore, duke njoftuar më parë shërbimet përkatëse në Kuvend, si dhe kur janë në mbledhjet e grupeve parlamentare ose në grupe të ndryshme pune të ngritura nga Kuvendi ose nga komisionet".

<sup>15</sup> Ky autoritet shtrihet edhe përtej hapësirave të Kuvendit kur deputeti është në veprimtari parlamentare psh. në një vizitë monitoruese, delegacion etj.

<sup>16</sup> Shih: Kodi i Etikës së Saeima-s, neni 7 në linkun <https://likumi.lv/ta/en/en/id/57517> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023)

<sup>17</sup> Shih: Rregullorja e Dhomës së Deputetëve të Parlamentit Italian, nenet 58-60, në linkun [https://www.camera.it/leg18/438?shadow\\_regolamento\\_capi=992&shadoe\\_regolamento\\_articoli\\_titolo=Articolo%2062%20\(\\*\)](https://www.camera.it/leg18/438?shadow_regolamento_capi=992&shadoe_regolamento_articoli_titolo=Articolo%2062%20(*)) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023)

<sup>18</sup> Shih: Rregullorja e Kuvendit të Kosovës neni 63, pika 2 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023)

<sup>19</sup> Shih: Kodi i Sjelljes Etike të Deputetit të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, neni 6 në linkun <https://www.sobranie.mk/kodi.nspix> (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023)





# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR



Kodet e Sjelljes parashikojnë edhe dispozita që rregullojnë reagimet e papërshtatshme (përçmuese apo ofenduese) ndaj deklaratave të deputetëve të tjerë në sallë, si gjestikulacione me ose pa konotacion seksual deri tek ngacmimet seksuale. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) u ka bërë thirrje parlamenteve kombëtare që të *inkurajojnë anëtarët e parlamentit që të përdorin gjuhë joseksiste dhe të mos përdorin stereotipe seksiste gjatë aktiviteteve të tyre parlamentare*<sup>20</sup>,

ndërsa Parlamenti Evropian ka miratuar rezolutën kundër ngacmimit dhe abuzimit seksual në BE<sup>21</sup>. Referuar Kodit të Sjelljes deputetit i ndalohet çdo sjellje me natyrë seksuale, që prek dinjitetin e cilitdo<sup>22</sup>.



Kodi i Sjelljes për deputetët në Parlamentin Kanadez, Dhoma e Ulët, ofron një përkufizim të ngacmimit seksual që mbulon *çdo sjellje të një natyre seksuale, duke përfshirë, një koment, gjest ose kontakt, një herë apo të përsëritur, që në mënyrë të arsyeshme mund*

<sup>20</sup> Shih: Combating sexist stereotypes in the media-Komisioni për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat, neni 7.4 në linkun <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=12456&lang=en> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>21</sup> Shih: Rezoluta e vitit 2017 kundër ngacmimit dhe abuzimit seksual në BE - Ngacmimi seksual në parlamente përfshirë parlamentin evropian, pikat 15-26 në linkun [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0417\\_EN.html?redirect](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2017-0417_EN.html?redirect) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>22</sup> Neni 10 pika 1 - KSDKRSH. Masa disiplinore: përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/organet e Kuvendit deri në 10 ditë (neni 65/1 - Rregullore Kuvendit).





# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

të shkaktojë ofendim ose poshtërim<sup>23</sup>. Pa u kufizuar, ngacmimi seksual në çfarëdo mënyre, mund të përfshijë sa vijon:

- (a) kërkesat për favore seksuale ose sulmet seksuale;
- (b) kontaktet fizike të papërshtatshme ose të padëshiruara si prekja, përkëdhelja ose shtrëngimi;
- (c) komentet fyese, gjestet ose shaka të natyrës seksuale, që shkaktojnë shqetësim ose siklet;
- (d) pyetje ose komente të papërshtatshme për jetën seksuale të një individi.

Në mars 2018, Sekretari i Jashtëm u qortua nga Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Mbretërisë së Bashkuar, për përdorimin e një gjuhe seksiste pasi iu drejtua koleges me titullin dhe mbiemrin e bashkëshortit të saj, ndërkohë që ajo mbante mbiemrin e vajzërisë. Kjo gjuhë u konsiderua si "e papërshtatshme" dhe seksiste nga Kryetari i Parlamentit. Në raste të tjera janë konsideruar si të pahijshme fjalët: *roje zezake, frikacak, huligan, mi, derr, pëllumb, tradhtar etj*<sup>24</sup>. Një ligjvënës konservator në Britaninë e Madhe, (2018) u përjashtua nga partia dhe më vonë dha dorëheqjen e tij pasi u shpall fajtor për sulm seksual ndaj një adoleshenteje<sup>25</sup>, ndërsa një raport parlamentar i vitit 2018, po në Britani, Dhoma e Ulët, zbuloi se gati një në pesë persona që punonin në Parlament ishte ngacmuar seksualisht ose ishte dëshmitar i sjelljeve seksualisht të papërshtatshme për vitin 2017<sup>26</sup>.



<sup>23</sup> Shih: Code of Conduct for Members of the House of Commons: Sexual harassment between members, pika 2 në linkun <https://www.ourcommons.ca/procedure/standing-orders/appa2-e.html> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023)

<sup>24</sup> Shih: Fjalor termash në linkun <https://www.parliament.uk/site-information/glossary/unparliamentary-language/> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>25</sup> Raport per UK. <https://www.nytimes.com/2022/05/03/world/europe/britain-parliament-sexual-harassment.html> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>26</sup> Shih: Report of Cross-Party Working Group on an Independent Complaints and Grievance Policy 2018 fq. 15 në linkun <https://questions-statements.parliament.uk/written-statements/detail/2018-02-08/HCWS460> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR



## VOTIMI PËR TË TRETËT<sup>27</sup>

Pjesëmarrja në votim dhe shprehja e vullnetit politik ose personal nëpërmjet votës është ushtrim i funksionit të deputetit<sup>28</sup>. Deputeti ushtron të drejtën e tij absolute për të votuar personalisht në komisione apo seancë plenare dhe kjo përbën një nga parimet bazë të demokracisë përfaqësuese. Rregullorja e Kuvendit<sup>29</sup> dhe Kodi i Sjelljes<sup>30</sup> gjatë zhvillimit të procedurave vendimmarrëse kërkojnë që të mbahen në konsideratë rregullat e parashikuara sipas së cilave *votimi është vetjak, e drejta e votës nuk delegohet dhe ndalohet pengimi i pjesëmarrjes në votim i kolegëve (deputetëve) duke përdorur presionin apo dhunën*<sup>31</sup>. Në të kundërt, kryerja nga deputeti gjatë zhvillimit të procedurave vendimmarrëse të veprimeve të mësipërme sjellin përgjegjësinë disiplinore të deputetit.

Kuvendi ka juridiksionin ekskluziv të shqyrtimit dhe ndëshkimit disiplinor të rasteve kur deputetët, me anë të veprimeve të tyre cenojnë ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të deputetëve të tjerë. Nëse anëtarët e Kuvendit nuk respektojnë Kodin e Sjelljes dhe votojnë për të tretët (kolegët e tyre) apo pengojnë pjesëmarrjen në votim të kolegëve të

<sup>27</sup> Neni 7, Kodi i Sjelljes në Kuvendin e RSH

<sup>28</sup> Vendim nr. 44/2011 i Gjykatës Kushtetuese

<sup>29</sup> Neni 57, Kodi i Sjelljes në Kuvendin e RSH

<sup>30</sup> Neni 7, Kodi i Sjelljes në Kuvendin e RSH

<sup>31</sup> Udhëzuesi i detajuar i Kodit të Sjelljes së Deputetëve, miratuar me vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 19, datë 27.9.2018

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

tyre atëherë Kryetari i Kuvendit ose Kryetari i Komisionit Parlamentar<sup>32</sup> ka autoritetin dhe kompetencën të disiplinojë parlamentarët duke dhënë ndaj tyre masën disiplinore të përjashtimit nga seanca plenare apo mbledhja e organit të Kuvendit, masë e cila shoqërohet me sanksion financiar të barabartë me ndalesën e pagës së deputetit për atë ditë<sup>33</sup>.

Disa parlamente e ndalojnë në mënyrë eksplicite këtë praktikë në rregullat e tyre të procedurës. Për shembull në parlamentin bullgar një nga kompetencat e Sekretarëve të parlamentit është edhe *parandalimi dhe sanksionimi në rast votimi me kartën e kolegut*<sup>34</sup>; në parlamentin gjeorgjian dispozitat në lidhje me procesin e votimit parashikojnë *votimin personal dhe se transferimi i së drejtës së votës ose i kartës së votimit është i papranueshëm*<sup>35</sup>, Statuti i Seimas së Republikës së Lituaniës parashikon *paralajmërim për përjashtim nga seanca në rast votimi të pandershëm*<sup>36</sup>, Rregullorja e parlamentit francez ndalon veprimet që pengojnë procesin e votimit *veçanërisht në lidhje me natyrën personale të së drejtës për të votuar*<sup>37</sup>, ndërsa Rregullorja e Kuvendit të Kosovës parashikon se *votimi është individual dhe e drejta e votës nuk delegohet*<sup>38</sup>.



<sup>32</sup> Ky fenomen ndodh vetëm në seancë plenare pasi në komisione deputetët votojnë me kartona dhe jo elektronikisht sikurse në seancë.

<sup>33</sup> Neni 65/1/b/3 Rregullore Kuvendit të RSH

<sup>34</sup> Shih: Rregullorja e Funkcionimit dhe Organizimit të Asamblesë Kombëtare të Bullgarisë, neni 10 pika 2 në linkun <https://www.parliament.bg/en/podns> (Aksesuar për herë të fundit më 19.9.2023)

<sup>35</sup> Shih: Rregullorja e parlamentit të Gjeorgjisë, neni 95 pika 8 në linkun <https://matsne.gov.ge/en/document/view/4401423?publication=27> (Aksesuar për herë të fundit më 19.9.2023)

<sup>36</sup> Shih: Statuti i Seimas së Republikës së Lituaniës, neni 20 pika 2 në linkun <https://e-seimas.lrs.lt/portal/legalAct/lt/TAD/d9766070c2f511e883c7a8f929bfc500?jfwid=39x432mh7> (Aksesuar për herë të fundit më 19.9.2023)

<sup>37</sup> Shih: Rregullorja e Asamblesë Kombëtare Franceze, nenet 77 dhe 77/-1 në linkun <https://www2.assemblee-nationale.fr/langues/welcome-to-the-english-website-of-the-french-national-assembly> (Aksesuar për herë të fundit më 22.9.2023)

<sup>38</sup> Shih: Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, neni 61 pika 7 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61266> (Aksesuar për herë të fundit më 19.9.2023)



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Një praktikë e tillë e sjelljes së deputetëve, e njohur ndryshe si fenomeni i “votimit fantazmë”, përbën shqetësim serioz të vazhdueshëm në shumë parlamente pasi përveçse është në kundërshtim me standardet e larta profesionale dhe etike të deputetit, të cilat janë parakusht për të ndërtuar besimin e publikut në punën e të zgjedhurve të tij dhe në integritetin e tyre, ngre pikëpyetje edhe për legjitimitetin e vendimmarrjes<sup>39</sup>. Në vitin 2015 mediat italiane publikuan pamje të senatores A. Silvestro duke votuar edhe për kolegun<sup>40</sup>. Në 2 shkurt 2023 një deputet shqiptar u filmua duke votuar edhe për kolegun<sup>41</sup>, por Kuvendi nuk pati ndonjë reagim institucional. Në Kosovë dhe vende të tjera të rajonit ka pasur gjithashtu njoftime të njëjta gjatë vitit 2023.

Deputeti duhet të veprojë me mirëbesim dhe të zbatojë me rigorozitet dispozitat që rregullojnë procesin vendimmarrës. Në disa vende, këtij fenomeni i ka dhënë fund instalimi i sistemit elektronik digjital (me gjurmë gishti)<sup>42</sup>.

## KONFLIKTI I INTERESIT<sup>43</sup>

Ndër sjelljet joetike të deputetit dhe që trajtohet nga një kuadër i gjerë normativ, që nga kushtetuta, ligje të posaçme e deri tek kodet e sjelljes, është edhe nocioni i konfliktit të interesit, i cili në thelb konsiston në atë që *interesat privatë të deputetit ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij*. Mbrojtja e interesit publik dhe promovimi i tij është kryefjala e mandatit të parlamentarit si përfaqësues i popullit në Kuvend. Prandaj edhe interesat privatë të tij nuk mund të prevalojnë ndaj interesave të zgjedhësve që ai përfaqëson. Për këtë arsye, adresimi i konflikteve të interesit, parandalimi ose kufizimi i tij, është në qendër të pothuajse të gjitha regjimeve etike parlamentare dhe një nga objektivat kryesorë të rregullimit të sjelljes profesionale të deputetit.

Rastet e konfliktit të interesit të deputetit lidhen ngushtësisht me:

- vendimmarrjen e deputetit<sup>44</sup>; dhe/ose
- raste të veçanta, që Kushtetuta apo ligji i cilësojnë si *papajtueshmëri me mandatin* dhe që gjejnë trajtim nga Kodi i Sjelljes si “Kufizime gjatë ushtrimit të mandatit”, “Veprimtaria joparlamentare e lejuar e deputetit” apo “Kufizime pas përfundimit të mandatit”.

<sup>39</sup> Legjitimiteti i vendimmarrjes vihet në pikëpyetje në rastet kur akti ka marrë kufirin minimal të votave *pro* që kërkohen për miratim.

<sup>40</sup> Shih: [https://www.facebook.com/NurseTimes.NT/videos/annalisa-silvestro-pianista-in-azione/1735338086699419/?locale=es\\_LA](https://www.facebook.com/NurseTimes.NT/videos/annalisa-silvestro-pianista-in-azione/1735338086699419/?locale=es_LA) (Aksesuar për herë të fundit më 22.09.2023).

<sup>41</sup> Shqiptarja. <https://shqiptarja.com/lajm/po-voton-dhe-per-kolegen-e-tij-qe-mungon-deputeti-i-ps-kapet-mat>

<sup>42</sup> Shih: [https://it.wikinews.org/wiki/Parlamento:\\_a\\_febbraio\\_finisce\\_l%27era\\_dei\\_%C2%ABpianisti%C2%BB](https://it.wikinews.org/wiki/Parlamento:_a_febbraio_finisce_l%27era_dei_%C2%ABpianisti%C2%BB) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>43</sup> Neni 13 dhe 14 - KSDKRSH

<sup>44</sup> Referuar LPKIUFPP-së bëhet fjalë për akte normative, si dhe vetëm për ato ligje që krijojnë pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara. Shih: Neni 4, pika 1, shkronja a.iii - LPKIUFPP në linkun: <https://www.dap.gov.al/images/LegjislacioniAP/Ligj%20nr.9367,%20date%207.4.2005%20Per%20parandalimin%20e%20konfliktit%20e%20interesave.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 23.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Rastet që lidhen me vendimmarrjen e deputetit kërkojnë një vëmendje të veçantë. Gjatë ushtrimit të mandatit parlamentar është e pashmangshme që deputeti të mos përballet me raste të konfliktit të interesit. Vendimmarrjet për ligje që lidhen me bizneset e tyre familjare ose të personave të lidhur me deputetin, emërimin/zgjedhjen në organe kushtetuese apo të krijuara me ligj të familjarëve të tyre, emërimin e tyre si anëtarë të Këshillit të Ministrave apo në organe të tjera janë ndër rastet në të cilat deputeti përballet me konflikt interesi. Madje, edhe promovimi i projektligjeve për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta konsiderohet rast i konfliktit të interesit<sup>45</sup>.

Kodet e sjelljes vendosin detyrimin e deputetit për të deklaruar çdo rast të konfliktit të interesit<sup>46</sup> prandaj deputeti, për të përmbushur këtë detyrim, duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të deklaruar konfliktin në momentin më të parë të mundshëm. Referuar ligjit 9367/2005 aktet e nxjerra në praninë e konfliktit faktik të interesit, janë relativisht të pavlefshme<sup>47</sup>.

Kodet e Sjelljes krijojnë mekanizma për t'u ardhur në ndihmë deputetëve kur ata janë në dilemë nëse ndodhen apo jo në situata që përbëjnë konflikt interesi. Ndihma konsiston në këshilla ose udhëzime. Për shembull, anëtarët e PE-së kur janë në dilemë mund t'i drejtohen Presidentit të Parlamentit, ndërsa kur kanë paqartësi mund të këshillohen me Komisionin e Këshillimit për Etikën e Parlamentarëve<sup>48</sup>. Disa vende, si Franca apo Australia, të cilat ndjekin modelin e rregullimit të jashtëm të çështjeve të etikës së parlamentarit, përdorin edhe Këshilltarin për Etikën, të cilët këshillojnë në mënyrë konfidenciale ligjvënësit<sup>49</sup>.

Në rastet kur deputeti përfshihet në situata konflikti interesi (konkretisht në rastet e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit), legjislacioni shqiptar parashikon pasojën më të rëndë ndaj tij, heqjen e mandatit parlamentar nga Gjykata Kushtetuese<sup>50</sup> apo

<sup>45</sup> Shih nenin 13/4 - KSDKRSH në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>46</sup> Shih nenin 13 pikat 2 dhe 3 - KSDKRSH në linkun <https://web-api.parlament.al/Files/Kodi%20i%20Sjelljes.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>47</sup> Shih: Neni 40, pika 4. Shënim: Duke qenë se Kuvendi është organ kolegjal dhe për pasojë vendimmarrjet e deputetëve janë kolegjiale, vlerësimi për vlefshmërinë e akteve të tilla kërkon një vlerësim të kujdesshëm dhe më kompleks. Por në rastet kur akti ka marrë kufirin minimal të votave "pro" që kërkojnë për miratim, pra kur vota e deputetit në konflikt interesi ka qenë përcaktuese në miratimin e aktit, kjo sjell automatikisht shfuqizimin e tij nga Gjykata Kushtetuese. P.sh. për miratimin e Kodit Penal kërkojnë detyrimisht të paktën 84 vota "pro". Pas miratimit (rezultojnë 84 vota pro) konstatohet se një deputet ka qenë në konflikt interesi, por nuk e ka deklaruar këtë situatë. Duke qenë se vota e tij, në këtë rast, është e pavlefshme, pra nuk llogaritet, kjo sjell edhe shfuqizimin e ligjit të miratuar për këtë shkak nga organi përkatës (Gjykata Kushtetuese). E njëjta situatë mund të ndodhë edhe nëse kërkohet shumicë e thjeshtë votash për miratim.

<sup>48</sup> Shih: Kodi i sjelljes së anëtarit të PE-së në lidhje me interesat financiare dhe konfliktin e interesit në linkun [https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305\\_Code\\_of\\_conduct\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305_Code_of_conduct_EN.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>49</sup> Shih: Appointment of a Parliamentary Integrity Adviser for the 60th Parliament, 2023 në linkun <https://new.parliament.vic.gov.au/49e503/globalassets/sections-shared/get-involved/inquiries/committees/lc-committees/lc-privileges/jointpriv-60-01-appointment-of-pia-for-60th-parliament.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>50</sup> Shih: Neni 70, pika 3 Kushtetutë në linkun <https://qzb.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd> (Aksesuar për herë të fundit më 23.09.2023).



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Kuvendi<sup>51</sup>. Ndërsa në rastet e konfliktit të interesave, që lidhen me vendimmarrjen e deputetit, ndonëse ligji 9367/2005 autorizon institucionin publik, në këtë rast Kuvendin, për ndërmarrjen e procedurave të dënimit disiplinor ndaj deputetit, shkaktar i pavlefshmërisë së aktit, Kodi i Sjelljes apo Rregullorja e Kuvendit nuk parashikojnë masë disiplinore ndaj deputetit që nuk përmbush detyrimin për deklarim kur ndodhen në konflikt interesi aq më tepër kur ata bëhen shkaktarë për pavlefshmërinë e aktit. Në raste të tilla përgjegjësia e deputetit mbetet morale dhe jo disiplinore.

Efektiviteti i zbulimit të rasteve të konfliktit të interesave mbështetet mbi të gjitha në aftësinë dhe kapacitetin e publikut, medias dhe shoqërisë civile për të identifikuar raste të tilla dhe për të gjykuar nëse me të vërtetë kemi të bëjmë me konflikt interesi<sup>52</sup>. Për këtë arsye, Unioni Ndërparlamentar u ka bërë thirrje parlamenteve që të lejojnë përfshirjen e OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë të jashtëm në monitorimin e zbatimit të kodeve të sjelljes. Kjo rrit besimin e publikut tek parlamenti<sup>53</sup>.

Në Suedi, deputetëve u lejohet të kenë interesa të caktuara, por u kërkohet të mos diskutojnë dhe të mos votojnë në këto raste<sup>54</sup>. Në Kanada, Kodi i Konfliktit të Interesave, shtojcë e Rregullores së Dhomës, parashikon *deklarimin e konfliktit të interesit, sa më parë, pranë nëpunësit përgjegjës, me gojë ose me shkrim dhe përjashtimin e deputetit nga diskutimi dhe votimi i çështjes*<sup>55</sup>. Në Kosovë Kodi i Mirësjelljes dhe Konfliktit të Interesave parashikon shprehimisht se *deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një çështje për të cilën vendimi mund të rezultojë me përfitim financiar për të dhe i njëjti as që do të pranohej nga një kategori e gjerë e njerëzve që nuk janë deputetë të Kuvendit ose nga të afërmit e deputetëve të Kuvendit*<sup>56</sup>.

<sup>51</sup> Shënim: Në vendimin nr. 2/2023 të Gjykatës Kushtetuese, për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës apo ligjeve tek të cilat ai referon, Gjykata vlerëson se: "Kushtetuta lë të kuptohet se këto raste papajtueshmërie janë çështje që i përkasin Kuvendit".

<sup>52</sup> Shih: Parliamentary Integrity: A Resource for Reformers, 2022 fq. 54 cit. në linkun [https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576_2.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>53</sup> Shih: Inter-parliamentary Union 2022, fq. 255

Indicators for democratic parliaments. <https://www.ipu.org/impact/democracy-and-strong-parliaments/ipu-standards/indicators-democratic-parliaments> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>54</sup> Shih: Transparency and Members of Parliaments' Financial Interests in the European Union fq. 24 në linkun [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/1996/212403/DG-4-JOIN\\_ET\(1996\)212403\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/1996/212403/DG-4-JOIN_ET(1996)212403_EN.pdf).

<sup>55</sup> Shih: Conflict of Interest Code for Members of the House of Commons pikat 12-13 në linkun <https://www.ourcommons.ca/procedure/standing-orders/Appa1-e.html> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>56</sup> Shih: Ligji nr. 03/I-111 "Për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit", kreu VII Kodi i Mirësjelljes dhe Konflikti i Interesave, neni 44 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2680> (Aksesuar për herë të fundit më 22.09.2023).

## KUFIZIME GJATË USHTRIMIT TË MANDATIT/VEPRIMTARIA JOPARLAMENTARE E LEJUAR E DEPUTETIT<sup>57</sup>

Në shumicën e regjimeve të etikës dhe sjelljes ka edhe kufizime përsa i përket ushtrimit të disa veprimtarive të deputetit, të cilat konsiderohen si të papajtueshme me anëtarësimin në organin legjislativ. Mosrespektimi i kufizimeve të tilla, të cilat parashikohen kryesisht në kushtetutë, por edhe në ligje të veçanta, passjell humbjen e mandatit të deputetit. Disa parlamente, për të ruajtur pavarësinë e parlamentarëve dhe për të shmangur konfliktet midis interesave privatë dhe detyrave të tyre publike vendosin ndalime përsa i përket disa apo të gjitha aktiviteteve të jashtme. Praktika shqiptare lejon në raste të caktuara ushtrimin e veprimtarive të jashtme përsa kohë që këto veprimtari nuk bien ndesh me funksionin si deputet dhe nuk përfshihen në kategorinë e funksioneve që përbëjnë kufizime gjatë ushtrimit të mandatit<sup>58</sup>. Për shembull deputeti mund të ushtrojë veprimtari të natyrës profesionale si mësimdhënie, të natyrës artistike, social kulturore, sportive ose të një natyre të ngjashme me to. Në çdo rast deputeti duhet të deklarojë aktivitetin e jashtëm tek Kryetari i Kuvendit dhe/ose kryetari i grupit parlamentar anëtar i të cilit është.

Kur deputetët lejohen të ushtrojnë aktivitete të jashtme kanë detyrimin për deklarim të të ardhurave nga këto aktivitete. Duke u kërkuar parlamentarëve deklarimin e këtyre aktiviteteve publiku mund të ndërgjegjësohet për çdo konflikt të mundshëm interesi, t'i mbajë deputetët përgjegjës për veprimet e tyre dhe të ketë më shumë besim se ata po veprojnë në interes të publikut dhe jo për përfitime personale. Transparenca e veprimtarive të jashtme të deputetëve (çfarë pune dhe sa paguhet), është një aspekt i rëndësishëm i garantimit të llogaridhënies dhe integritetit në sistemin politik.

- Në Kongresin Amerikan ligjvënësit e kanë të lejueshme të fitojnë të ardhura nga veprimtari të jashtme, por deri në një kufi të caktuar<sup>59</sup>.
- Në Mbretërinë e Bashkuar, deputetët mund të jenë mjekë, gazetarë, juristë apo edhe drejtorë kompanish dhe të fitojnë të ardhura nga ky rol, por njëkohësisht u kërkohet deklarimi i të ardhurave në Regjistrin e Interesave Financiare<sup>60</sup>.

<sup>57</sup> Neni 17 dhe 20 – KSDKRSH.

<sup>58</sup> Deputetit nuk i lejohet: a) të ushtrojë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave; b) të kryejë veprimtari fitimprurëse, që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojë pasuri të këtyre; c) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse; ç) të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën "c" dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër; d) të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

<sup>59</sup> Shih: Highlights of the House Ethics Rules (2023) në linkun

<https://ethics.house.gov/sites/ethics.house.gov/files/documents/FINAL%20Highlights%20Overview%20Booklet%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 23.09.2023).

<sup>60</sup> Shih: Kodi i Sjelljes, Dhoma e Përfaqësuesve, kapitulli 4, fq. 39 në linkun

<https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1083/1083.pdf> dhe

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

- Në Kroaci, deputetët lejohen të ushtrojnë aktivitete të jashtme si anëtarësime në borde, aktivitete arsimore ose të tjera. Pagesat e ardhura nga këto aktivitete bëhen publike nga Komisioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në faqen e tij të internetit<sup>61</sup>.
- Në Francë, deputetët mund të ushtrojnë veprimtari të jashtme, por u kërkohet që t'i deklarojnë nëse mund të krijojnë konflikt interesi me ushtrimin e detyrës si deputet. Ata duhet të deklarojnë çdo punë me pagesë, punë konsulce ose aktivitete të tjera, që gjenerojnë të ardhura ose përfitime<sup>62</sup>. Edhe Kodi Zgjedhor rendit një sërë papajtueshmëri të mundshme ndërmjet ushtrimit të detyrës si deputet dhe aktiviteteve të jashtme, duke përfshirë ndalimin e çdo funksioni apo aktiviteti të paguar nga një shtet i huaj<sup>63</sup>. Një raport i Transparency International tregon se 72 % e deputetëve francezë, 85% e deputetëve letonezë dhe 74% e deputetëve hollandezë përveç funksionit publik ushtrojnë edhe veprimtari të jashtme.<sup>64</sup>
- Në Kosovë, deputeti nuk mund të jetë edhe kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër ose zëvendësministër (Mospërputhshmëria me funksionin e ekzekutivit) si dhe nuk mund të jetë anëtar bordi në ndonjë kompani private ose publike, nuk mund të veprojë në cilësinë e këshilltarit apo përfaqësuesit ligjor të asnjë kompanie ose biznesit, nuk mund të jetë kryeredaktor apo zëvendëskryeredaktor në media të shkruara apo elektronike, me përjashtim të atyre partiake, nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e avokatit si dhe nuk mund të kryejë aktivitete ekonomike, që krijojnë konflikt të interesit (Mospërputhshmëria me aktivitetet ekonomike)<sup>65</sup>.

<https://publications.parliament.uk/pa/cm/cmregmem/contents2223.htm> si dhe <https://ukandeu.ac.uk/explainers/mps-second-jobs-and-outside-interests/> (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).

<sup>61</sup> Shih: Ligji për konfliktin e interesave në linkun [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2021\\_12\\_143\\_2435.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2021_12_143_2435.html) (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).

<sup>62</sup> Shih: Rregullorja e Asamblesë Kombëtare Franceze, neni 79 në linkun <https://www2.assemblee-nationale.fr/langues/welcome-to-the-english-website-of-the-french-national-assembly> (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023)

<sup>63</sup> Shih: Kodi zgjedhor, kreu IV në linkun [https://www.legifrance.gouv.fr/codes/texte\\_lc/LEGITEXT000006070239/](https://www.legifrance.gouv.fr/codes/texte_lc/LEGITEXT000006070239/) (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).

<sup>64</sup> Shih: Transparency International, 2020, Debugging democracy - Open data for political integrity in Europe fq. 14 në linkun [https://images.transparencycdn.org/images/2020\\_Report\\_DebuggingDemocracy\\_English.pdf](https://images.transparencycdn.org/images/2020_Report_DebuggingDemocracy_English.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).

<sup>65</sup> Shih: Ligji nr. 03/I-111 "Për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit", kreu VII Kodi i Mirësjelljes dhe Konflikti i Interesave, neni 6-7 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2680> (Aksesuar për herë të fundit më 22.09.2023)

## KUFIZIMET PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT<sup>66</sup>

Një nga çështjet e diskutueshme të Kodit është edhe vendosja e disa kufizimeve në punësimin e ligjvënësve pas mbarimit të mandatit si deputet. Ligjvënësit dhe në veçanti ministrat, gjatë ushtrimit të mandatit, kanë akses në informacione shumë të rëndësishme kur janë në detyrë dhe ka të ngjarë që për përfitime private t'i shfrytëzojnë ato pas mbarimit të mandatit. Prandaj, regjimet e etikës dhe sjelljes, për të mbrojtur interesin publik, vendosin kufizime për ish-ligjvënësit sidomos në fusha të caktuara si industri, ekonomi etj.

- Në BE periudha e kufizimit pas mandatit është dy vjet për komisionerët dhe tre vjet për Presidentin e KE-së, ndërkohë që edhe këtu nuk ka ndonjë ndalim për eurodeputetët<sup>67</sup>.
- Në Francë parashikohet një afat 3-vjeçar pritjeje për të punuar në sektorin privat<sup>68</sup>. Gjatë këtyre tre viteve, ish-deputetëve u ndalohet të angazhohen në aktivitete që mund të krijojnë konflikt interesi ose mund të japin përshtypjen e parregullësive si p.sh. përdorimi i informacionit të marrë gjatë ushtrimit të detyrës për përfitime personale.
- Në Mbretërinë e Bashkuar, ish-deputetëve u ndalohet që për një periudhë kohe 2-vjeçare të angazhohen në aktivitete lobimi. Kjo synon të parandalojë ish-deputetët që të përdorin lidhjet dhe njohuritë e tyre të brendshme për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në vendimet e qeverisë. Gjithashtu siguron që ish-deputetët të mos kenë një avantazh të padrejtë në lobimin e qeverisë dhe në këtë mënyrë të mbrohet interesi publik<sup>69</sup>.
- Në Maqedoninë e Veriut ish-deputetët mund të kryejnë lobim pas skadimit të tre viteve nga dita e ndërprerjes së mandatit<sup>70</sup>.
- Në Serbi, Agjencia Kundër Korrupsionit ndalon zyrtarët publikë (për një periudhë 2-vjeçare pas largimit nga detyra) që të punësohen në organizata me të cilat janë angazhuar në aktivitete gjatë detyrës. Nga ky ndalim përjashtohen zyrtarët e zgjedhur<sup>71</sup>.

<sup>66</sup> Neni 27 - KSDKRSH

<sup>67</sup> Shih: Kodi i Sjelljes së KE-së, neni 11 në linkun [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018D0221\(02\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018D0221(02)&from=EN) (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023) "Ish-deputetët e Parlamentit Evropian, të cilët angazhohen në aktivitete lobimi ose përfaqësimi profesional të lidhura drejtpërdrejt me procesin e vendimmarrjes së Bashkimit Evropian, nuk mund të përfitojnë, gjatë gjithë periudhës në të cilën ata angazhohen në këto aktivitete, nga lehtësitë e dhëna për ish-deputetët sipas rregullave të përcaktuara nga Byroja për këtë qëllim". (Neni 6 - Kodi i Sjelljes së PE-së në linkun [https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305\\_Code\\_of\\_conduct\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305_Code_of_conduct_EN.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).

<sup>68</sup> De Vrieze F. (2011) në "Independent oversight institutions and regulatory agencies, and their relationship to parliament", WFD (Westminster Foundation for Democracy), London February 2019, faqe 23 aksesuar për herë të fundit më 18 prill 2023 (cit.) <https://www.wfd.org/what-we-do/resources/independent-oversight-institutions-and-regulatory-agencies-and-their>

<sup>69</sup> Shih: Transparency of Lobbying, Non-Party Campaigning and Trade Union Administration Act 2014 në linkun <https://www.legislation.gov.uk/ukpga/2014/4/contents/enacted> (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023)

<sup>70</sup> Shih: Ligji për lobim, neni 7 në linkun <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2022/01/LIGJI-PER-LOBIM.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023).

<sup>71</sup> Shih: Ligji për Agjencinë Anti-Korrupsion (Anti-corruption Agency act) neni 38 në linkun <https://www.osce.org/files/f/documents/7/8/35100.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR



Kodi i Sjelljes e lejon punësimin e ish-deputetit në sektorin privat, por me kufizimet e mëposhtme:

- *Deputeti ndalohet të përfshihet në marrëdhënie kontraktuale konsulence me Kuvendin, që përfshin çdo shërbim konsulence, i një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese;*
- *Kontratë pune ose biznesi me Kuvendin, që përfshin çdo marrëdhënie kontraktuale midis Kuvendit dhe ish-deputetit, që ushtron veprimtari në formën e personit fizik tregtar;*
- *Ushtrimin e avokatisë kur si palë kundërshtare në procesin gjyqësor është Kuvendi.*
- *Kufizimet shtrihen për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar nga dita e mbarimit të mandatit të deputetit. Pas kësaj periudhe ish-deputeti lirohet nga çdo lloj kufizimi.*



## LOBIMI<sup>72</sup>

Lobimi në mbarë botën është bërë një fenomen i rëndësishëm për diskutim kur bëhet fjalë për standardet etike të funksionarit publik/parlamentarëve. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në Rekomandimet e miratuara nga Këshilli mbi Parimet për Transparencë dhe Integritet në Lobim e përkufizon këtë të fundit si *komunikimin verbal ose me shkrim me një zyrtar publik për të ndikuar në legjislacion, politika ose vendime administrative, i cili shpeshherë fokusohet në degën legjislative. Megjithatë, ndodh edhe në pushtetin ekzekutiv, për shembull, për të ndikuar në miratimin e rregulloreve ose hartimin e projekteve dhe kontratave. Për rrjedhojë, termi zyrtar publik përfshin nëpunësit publikë, punonjësit dhe bartësit e funksioneve publike në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, qoftë të zgjedhur apo të emëruar.*<sup>73</sup>. Rekomandimet e OECD-së janë instrumenti i parë ndërkombëtar për të adresuar rreziqet e transparencës dhe integritetit, që lidhen me praktikën e lobimit.

Në çdo sistem demokratik, ndërveprimi i individëve ose grupeve të caktuara me ligjvënësit për të mbrojtur interesa specifike dhe për të ndikuar në vendimet politike paraqet disa rreziqe. Edhe pse praktika e lobimit është pjesë integrale e çdo demokracie dhe lobistët mund të kryejnë një rol të vlefshëm për të informuar ligjvënësit për çështje me interes publik, një përdorim i paligjshëm i ndikimit në sistemin politik mund të jetë jashtëzakonisht i rrezikshëm pasi sjell rrezikun e favoreve dhe rryshfeteve, shpërndarje jo të barabartë të konsideratave politike dhe burimeve shtetërore si dhe ulin besimin e publikut tek parlamenti<sup>74</sup>.

Praktika ndërkombëtare rekomandon që, në përgjithësi, të gjitha aspektet e lobimit duhet të rregullohen së pari me ligj dhe jo vetëm nëpërmjet një kodi sjelljeje<sup>75</sup>. Ky i fundit mund të trajtojë disa aspekte të kësaj çështjeje me qëllim që ligji të plotësohet sa më mirë. Ligjet për lobimin përgjithësisht përfshijnë aspekte si: regjistrimin vullnetar të lobistëve, të grupeve të interesit dhe OSHC-ve që mbajnë marrëdhënie me deputetin dhe komisionet me qëllim pjesëmarrjen e publikut në procesin legjislativ; deklarin e të ardhurave dhe shpenzimeve në aktivitetet lobuese; publikimin e regjistrimit të lobimit me qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të sistemit; dispozitat e "derës rrotulluese", që nënkupton kërkesat që vendosin një periudhë "ftohjeje" gjatë së cilës ish-ligjvënësit nuk mund të bëhen lobistë etj.

<sup>72</sup> Neni 21-22 KSDKRSH

<sup>73</sup> Shih: Recommendations of the Council on Principles for Transparency and Integrity in Lobbying, 2010, fq. 7 në linkun <https://legalinstruments.oecd.org/public/doc/256/256.en.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 07.09.2023).

<sup>74</sup> Shih: Parliamentary Integrity: A Resource for Reformers, 2022 fq. 69 cit. në linkun [https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576_2.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>75</sup> Shih: Recommended Benchmarks for Codes of Conduct applying to Members of Parliament, Commonwealth Parliamentary Association fq. 14 në linkun <https://www.cpahq.org/media/3wqhbhad/codes-of-conduct-for-parliamentarians-updated-2016-7.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 07.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Referuar praktikës ndërkombëtare, sidomos rajonit, ligji për lobimin është pjesë e rëndësishme e kornizës ligjore për luftimin e korrupsionit në procesin e vendimmarrjes publike. Vendosja e rregullave të qarta për lobim kontribuon edhe në fuqizimin e transparencës dhe rritjen e besimit të publikut tek institucionet shtetërore. Kur rregullohet në një mënyrë transparente, lobimi është një mundësi legjitime për individët dhe grupet e interesit për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse. Serbia në vitin 2019<sup>76</sup>, Maqedonia e Veriut në 2011<sup>77</sup> dhe Mali i Zi në 2014<sup>78</sup> kanë miratuar një ligj për lobimin. Në Maqedoninë e Veriut, aktivitetet e organizatave joqeveritare dhe grupeve të qytetarëve kanë luajtur një rol të rëndësishëm në miratimin, por edhe në ndryshimin e mëvonshëm të ligjit për lobim, kurse në Slloveni<sup>79</sup> dhe Mal të Zi, ky ligj ka dëshmuar se ka pasur efekt në parandalimin e ndikimit të padrejtë, reduktimin e rreziqeve të korrupsionit dhe fuqizimit të transparencës.

Si rregull, lobistët duhet t'i kryejnë aktivitetet e tyre me ndershmëri dhe integritet. Ata duhet të ndjekin disa kërkesa, si p.sh. të mos ofrojnë dhurata, donacione ose ndonjë avantazh me vlerë të konsiderueshme për ligjvënësin dhe të mos përdorin mënyra mashtruese për të marrë informacione prej tyre. Në Francë, kur Autoriteti i Lartë për Transparencën në Jetën Publike zbulon, me iniciativën e tij ose pas një raportimi, shkelje të rregullave të lobimit, ai i dërgon një njoftim zyrtar lobistit në fjalë. Njoftimi zyrtar, i cili mund të publikohet, urdhëron lobistin që të përmbushë detyrimet, pasi t'i lejojë ata të paraqesin përgjigjen e tyre. Pas lëshimit të njoftimit zyrtar, çdo shkelje e ardhshme e detyrimeve etike dënohet me një vit burgim dhe 15 mijë euro gjobë.

Shoqëria civile në Shqipëri ka theksuar mungesën e transparencës mbi ndikimin e sektorit privat në politikat e shtetit, projektet ose projektligjet dhe ka shprehur nevojën për rregullimin e kësaj çështjeje<sup>80</sup>. Lobimi mund të çojë për shembull në ndikim të padrejtë dhe konkurrencë të pandershme nëse është jotransparent, i parregulluar apo pjesërisht i rregulluar.

Rregullimi i lobimit në Shqipëri është bërë vetëm në Kodin e Sjelljes dhe Kodin Etik Ministror<sup>81</sup>. Referuar Kodit të Sjelljes së deputetët kanë detyrimin që të bëjnë publike të gjitha takimet e tyre me lobistët, OSHC-të, grupet e interesit (si brenda ashtu edhe jashtë

<sup>76</sup> Shih: [https://www.transparentnost.org.rs/images/dokumenti\\_uz\\_vesti/law\\_on\\_lobbying.pdf](https://www.transparentnost.org.rs/images/dokumenti_uz_vesti/law_on_lobbying.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>77</sup> Shih: <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2022/01/LIGJI-PER-LOBIM.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>78</sup> Shih: [https://track.unodc.org/uploads/documents/BRI-legal-resources/Montenegro/2-Law\\_on\\_Lobbying\\_EN.pdf](https://track.unodc.org/uploads/documents/BRI-legal-resources/Montenegro/2-Law_on_Lobbying_EN.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>79</sup> Shih: Transparency International. Lobbying regulation practices in Slovenia fq. 6 në linkun <https://www.riigikogu.ee/wpcms/wp-content/uploads/2020/12/Lobbying-regulation-practices-in-Slovenia.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023)

<sup>80</sup> Shih: Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri, WDF, 2020, fq. 33 në linkun <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Pjesemarrja-e-OSHC-ne-Vendimarrje-ne-Shqiperi-1.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 09.09.2023).

Shih: Zbërthimi i kapjes së shtetit në Shqipëri. Një shqyrtim i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe ligjeve të bëra me porosi nga viti 2008 deri në 2020 - IDM Albania & Transparency International (2021) në linkun [https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/2021\\_Report\\_DeconstructingStateCaptureAlbania\\_Albanian.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/2021_Report_DeconstructingStateCaptureAlbania_Albanian.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>81</sup> Shih: Kodi Etik Ministror në linkun <https://qbz.gov.al/preview/079d9de1-48f2-4e7d-adf5-eccec3ac74274/cons/20220506> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Kuvendit), objektin e diskutimeve dhe shkallën e mbështetjes, që do të sigurojë për kërkesat e paraqitura nga këto subjekte<sup>82</sup>. Shkelja e këtyre rregullave ngarkon me përgjegjësi disiplinore deputetin<sup>83</sup>.

## DHURATAT DHE PËRFITIMET E TJERA TË NGJASHME<sup>84</sup>

Një nga çështjet që gjen rregullim në kodet e sjelljes është edhe pranimi i dhuratave protokollare dhe përfitimeve të tjera të ngjashme. Akte të tjera të brendshme të parlamentit përfshijnë rregulla të detajuara, të cilat orientojnë deputetin në këtë drejtim. Megjithatë rregullat për pranimin e dhuratave protokollare ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri vend në tjetrin, praktika ndërkombëtare njihen tre qasje kryesore:

- I. **Ndalim.** Disa vende i ndalojnë deputetët të pranojnë dhurata, p.sh. Ligjvënësit amerikanë nuk mund të pranojnë dhurata nga subjektet vijuese: një lobist i regjistruar, agjent ose një drejtor i huaj ose nga një ent privat, që mban ose punëson individë të tillë. Ata mund të pranojnë dhurata vetëm nga burime të tjera kur vlera e dhuratës është nën 50\$ dhe nën 100\$ nga i njëjti burim në një vit kalendarik<sup>85</sup>.
- II. **Deklarim.** Disa vende të tjera lejojnë pranimin e dhuratave të çdo vlere, por kërkojnë deklarin e saj nga parlamentari sikurse praktika çeke<sup>86</sup>.
- III. **I përzier.** Një grup i tretë vendesh lejon pranimin e çdo dhurate deri në një vlerë të caktuar dhe kërkon që dhurata të deklarohet p.sh. Parlamenti Evropian përcakton pranimin e *dhuratave deri në një vlerë prej 150 €*<sup>87</sup>, Parlamenti Italian parashikon vlerën kufi 250 €<sup>88</sup>, Kuvendi i Kosovës pranon deri në 50 € dhe/ose deri në 250€/vit<sup>89</sup>, Parlamenti në Mbretërinë e Bashkuar - Dhoma e Ulët ka vendosur

<sup>82</sup> Neni 21

<sup>83</sup> Nenet 64 dhe 65/1 - Rregullore Kuvendi: Tërheqje vëmendjeje dhe në rast përsëritjeje përjashtim nga pjesëmarrja në organet e Kuvendit dhe/ose seancë plenare deri në 10 ditë.

<sup>84</sup> Neni 23 - KSDKRSH

<sup>85</sup> Shih: Highlights of the House Ethics Rules 2023 në linkun

<https://ethics.house.gov/sites/ethics.house.gov/files/documents/FINAL%20Highlights%20Overview%20Booklet%202023.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>86</sup> Shih: Ligji nr. 159/2006 për konfliktin e interesave në linkun neni 11 dhe 13 <https://www.psp.cz/en/docs/laws/2006/159.html> (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>87</sup> Shih: Kodi i Sjelljes së Parlamentit Evropian, neni 5/1 në linkun

[https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305\\_Code\\_of\\_conduct\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305_Code_of_conduct_EN.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 11.11.2023).

<sup>88</sup> Shih: Kodi i Sjelljes, Dhoma e Deputetëve, neni 4 në linkun

[https://www.camera.it/application/xmanager/projects/leg18/attachments/conoscerelacamera/upload\\_files/000/000/336/original\\_codice\\_condotta\\_deputati.pdf](https://www.camera.it/application/xmanager/projects/leg18/attachments/conoscerelacamera/upload_files/000/000/336/original_codice_condotta_deputati.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 11.11.2023).

<sup>89</sup> Shih: Ligji nr. 08/I-108 "Për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave", neni 23 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61304> (Aksesuar për herë të fundit më 21.09.2023) si dhe ligjin nr. 03/I-111 "Për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit", kreu VII Kodi i Mirësjelljes dhe Konflikti i Interesave, neni 46 në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2680> (Aksesuar për herë të fundit më 22.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

tavanin prej 300 £<sup>90</sup> etj. Parlamenti Shqiptar bën pjesë në këtë grup. Kodi i Sjelljes vendos kufirin e lejuar (10 mijë lekë) brenda të cilit deputeti mund të pranojë dhurata.

Me "dhuratë", referuar Kodit të Sjelljes kuptohet çdo send që i jepet deputetit pa shpërblim nga të tjerë në veprimtari të ndryshme parlamentare, gjatë të cilave deputeti, i vetëm ose si pjesë e një delegacioni, përfaqëson zyrtarisht Kuvendin. Me qëllim garantimin e transparencës në marrëdhëniet ndërmjet dhuratëdhënësit dhe parlamentarit, Kodi i Sjelljes vendos rregulla për deklarimin, brenda 5 ditëve<sup>91</sup>, të dhuratës së pranuar. Deputeti i drejtohet Shërbimit të Trajtimit të Deputetëve për të regjistruar dhuratën në regjistrin përkatës duke specifikuar në veçanti emrin e dhuruesit, datën dhe rrethanat e marrjes së dhuratës, vlerën e përafërt, si dhe një përshkrim të shkurtër të saj. Shkelja e rregullave për deklarim të dhuratës sjell masë disiplinore ndaj deputetit<sup>92</sup>.

Praktika ndërkombëtare për të fuqizuar transparencën dhe rritur besimin e publikut tek ligjvënësit parashikon bërjen publike të regjistrit të dhuratave nëpërmjet faqes zyrtare në internet, sikurse rasti Parlamentit Evropian<sup>93</sup> ose nëpërmjet ekspozitave të hapura për publikun për këtë qëllim në ambjentet e parlamentit, sikurse praktika çeke<sup>94</sup>.

Kodet e Sjelljes vendosin rregulla kufizuese edhe për mikpritjen duke parashikuar detyrimin e parlamentarëve që, në rastet kur merr pjesë në veprimtari të organizuara nga të tjerë dhe pjesëmarrja e tij, shpenzimet e udhëtimit, strehimit dhe të qëndrimit mbulohen prej palës pritëse ose të tretëve, të deklarojnë udhëtimet dhe akomodimet e sponsorizuara si dhe dietat e shpenzimet e ofruara. Kjo çështje disiplinohet për të shmangur abuzimet, shpenzimet e panevojshme apo keqpërdorimet, veçanërisht për përfitime politike apo personale të deputetit si dhe për të rritur besimin e publikut tek parlamenti. Të njëjtat standarde ndërkombëtare ndan edhe Kodi i Sjelljes. Kodi vendos rregulla edhe për afatin kohor brenda të cilit duhet bërë deklarimi<sup>95</sup> i përfitimeve të pranuar.

<sup>90</sup> Shih: Code of Conduct of House of Commons, Category 3: Gifts, benefits and hospitality from UK sources, pika 21, fq. 19 në linkun <https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1083/1083.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 11.11.2023).

<sup>91</sup> Neni 23/9 - KSDKRSH

<sup>92</sup> Neni 64, pika 1, shkronja d, pika 4 - Rregullore Kuvendi: Tërheqje vëmendjeje dhe në rast përsëritjeje përjashtim nga pjesëmarrja në organet e Kuvendit dhe/ose seancë plenare deri në 10 ditë.

<sup>93</sup> Shih: Regjistrin e dhuratave të Parlamentit Evropian në linkun [https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/gifts\\_register\\_9.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/gifts_register_9.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 14.09.2023).

<sup>94</sup> Shih: [https://www.praha.eu/jnp/en/monthly\\_news/do\\_not\\_miss\\_the\\_exhibition\\_of\\_state.html](https://www.praha.eu/jnp/en/monthly_news/do_not_miss_the_exhibition_of_state.html) (Aksesuar për herë të fundit më 19.09.2023).

<sup>95</sup> Neni 23/9 - KSDKRSH sipas të cilit deklarimi bëhet brenda 5 ditëve. Masa disiplinore e njëjtë me shkeljen e rregullave për dhuratat.



## DEKLARIMI DHE KONTROLLI I PASURISË<sup>96</sup>

Deklaratat e pasurisë, si një prej çështjeve që rregullohet nga kodet e sjelljes (njëkohësisht edhe nga ligje të posaçme) janë shndërruar në një instrument antikorrupsion të përdorur gjerësisht duke qenë se ndihmojnë në zbulimin e shenjave të hershme të pasurimit të paligjshëm. Deklaratat e pasurisë përfshijnë pronën, aksione, para, sende me vlerë dhe çdo investim tjetër. Në këto deklarata përfshihet edhe informacioni për detyrimet.

Rregullat për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, të detyrimeve financiare për deputetin, për familjarët e tij dhe për personat e lidhur me të, përcaktohen në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" të ndryshuar<sup>97</sup>. Referuar këtyre rregullave, deklarata paraqitet në mënyrë periodike (vjetore). Gjithashtu fillimi dhe mbarimi i mandatit janë momente që kërkojnë detyrimisht deklarimin e pasurisë. Deklarata paraqitet fizikisht megjithëse në disa vende, përfshirë Shqipërinë, aplikohet edhe dorëzimi elektronik, i cili përmirëson ndjeshëm pajtueshmërinë me kërkesat e deklarimit, ul koston e administrimit dhe rrit aksesin dhe llogaridhënien (siç dëshmohet nga rezultatet e vendeve që kanë futur procedura të tilla). Në Ukrainë, deklaratat elektronike të pasurisë janë prezantuar në vitin 2016, duke rezultuar në norma të larta përputhshmërie. Ato janë të disponueshme për publikun, duke ofruar mundësinë për qytetarët që të njihen me pasurinë e ligjvënësve. Në disa shtete të tjera një deklaratë interesi mund të dorëzohet vetëm fizikisht<sup>97</sup>.



<sup>96</sup> Neni 15 dhe 16 - KSDKRSH

<sup>97</sup> Shih: Asset declarations for public officials - A tool to prevent corruption (OECD 2011) fq. 70 në linkun [https://read.oecd-ilibrary.org/governance/asset-declarations-for-public-officials\\_9789264095281-en#page72](https://read.oecd-ilibrary.org/governance/asset-declarations-for-public-officials_9789264095281-en#page72) (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).



# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Deklaratat e pasurive, publikohen dhe në këtë kontekst, janë ngritur shqetësime në lidhje me sigurinë e parlamentarëve dhe privatësinë e tyre si dhe të pjesëtarëve të familjes. Në shumë vende, këto shqetësimet janë trajtuar duke kufizuar aksesin e publikut në të dhënat personale të këtyre personave. Për shembull adresa e vendbanimit të deputetit, si e dhënë konfidenciale personale mund të redaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare edhe Kodi i Sjelljes parashikon publikimin e deklaratës me të dhëna personale të reduktuara.

Në disa vende, OSHC-të kanë krijuar faqe interneti për të krahasuar deklaratat e pasurisë së deputetëve individualë me informacione të tjera të disponueshme publikisht për interesat e tyre<sup>98</sup>.

## MARRËDHËNIET ME STAFIN E PARLAMENTIT<sup>99</sup>

Marrëdhëniet e deputetit me stafin e Kuvendit janë një tjetër aspekt i rëndësishëm i kodeve të sjelljes. Pothuajse të gjitha kodet e sjelljes kanë një dispozitë specifike për marrëdhëniet me stafin e parlamentit. Këto marrëdhënie udhëhiqen kurdoherë nga respekti i ndërsjelltë.

- Kodi i Sjelljes së Dhomës së Ulët në Mbretërinë e Bashkuar parashikon se *parlamentarët duhet të trajtojnë stafin e tyre me dinjitet, mirësjellje dhe respekt*<sup>100</sup>.
- Kodi i Sjelljes së Kuvendit të Maqedonisë së Veriut parashikon se *deputeti i respekton autorizimet e të punësuarve në Shërbimin e Kuvendit, nuk do të ushtrojë presion gjatë kryerjes së detyrave të tyre të punës dhe nuk do të stimulojë dhe ndihmojë sjellje në kundërshtim me Kodin*<sup>101</sup>.
- Kodi i Sjelljes i parlamentit skocez thekson se *anëtarët e parlamentit duhet të trajtojnë stafin me kortezi dhe respekt. Deputetët nuk duhet të sillen me stafin në një mënyrë që përfshin bullizmin, ngacmimin (përfshirë atë seksual) ose çdo sjellje tjetër të papërshtatshme*<sup>102</sup>.

<sup>98</sup> <https://www.meineabgeordneten.at/> në Austri dhe <https://www.cumuleo.be/> në Belgjikë. Këto faqe interneti disponojnë informacione rreth deputetëve dhe politikanëve të tjerë të lartë me funksionet e tyre në kompani, të ardhurat e tyre shtesë, CV-të, informacionet e kontaktit dhe shumë më tepër duke përfshirë burime të kuptueshme.

<sup>99</sup> Neni 9 - KSDKRSH

<sup>100</sup> Shih: House of Commons, The Code of Conduct D/1 - Rules of conduct në linkun <https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1083/1083.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023)

<sup>101</sup> Shih: Kodi i Sjelljes Etike të Deputetit të Kuvendit të Maqedonisë, neni 6 në linkun <https://www.sobranie.mk/kodi.nspix> (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>102</sup> Shih: Kodi i Sjelljes fq. 53 në linkun <https://www.parliament.scot/msps/-/media/c160dbee10264603aafe30f11d3ffaed.ashx> (Aksesuar për herë të fundit më 20.09.2023).

## ZBATIMI I KODIT TË SJELLJES DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË TIJ

Praktika ndërkombëtare rendit një larmi të konsiderueshme të modeleve të zbatimit të kodeve të sjelljes, të cilat, kryesisht, dallohen, ndër aspekte të tjera, nga vendi ku ndodhet autoriteti përgjegjës i ngarkuar me zbatimin e tyre. Secili prej modeleve të renditura në vijim, paraqet avantazhe dhe disavantazhe<sup>103</sup>.

Vetërregullimi - vetë parlamenti monitoron zbatimin e kodit të sjelljes, shqyrton ankesat për thyerje të rregullave të sjelljes dhe etikës dhe vendos sanksione. Ndërkohë që ky model i ruan parlamentarët nga ndërhyrjet e jashtme, sidomos nga pushteti ekzekutiv, ai rrezikon gjithashtu të përjetësojë pandëshkueshmërinë e parlamentarëve nëse parlamenti nëpërmjet një organi të brendshëm nuk është i gatshëm që të shqyrtojë me kujdes sjelljen e kolegëve të tij. Parlamenti Italian<sup>104</sup>, Parlamenti Evropian<sup>105</sup>, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut<sup>106</sup>, Kuvendi i Shqipërisë ndjekin këtë model.

Rregullimi i jashtëm - një rregullator i jashtëm monitoron zbatimin e kodit, shqyrton ankesat për thyerje të rregullave të sjelljes dhe vendos sanksione. Ky organ i jashtëm mund të shihet si më legjitim, por mbart rrezikun e minimit të ndarjes së pushteteve. Gjithashtu, mund të dekurajojë deputetët nga marrja e përgjegjësisë për sjelljen e tyre dhe mbajtja e kolegëve përgjegjës për sjelljet e pahijshme. Franca ndjek këtë model.

Modeli i përzier - ky model kombinon tiparet e të dy modeleve, duke ruajtur avantazhet dhe duke zbutur disavantazhet e secilit model. Mbretëria e Bashkuar<sup>107</sup>, SHBA<sup>108</sup>, ndjekin këtë model.

Kodi i Sjelljes përcakton Byronë e Kuvendit si autoritetin përgjegjës për zbatimin e tij<sup>109</sup>. Byroja përveç kompetencave në çështjet e administrimit të brendshëm të parlamentit, ushtron edhe funksionet e shqyrtimit të ankesave të deputetëve ndaj masave të rënda

<sup>103</sup> Shih: Parliamentary Integrity: A Resource for Reformers, fq. 77

[https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576\\_2.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/4/a/511576_2.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023)

<sup>104</sup> Shih: Kodi i Sjelljes, Dhoma e Deputetëve

[https://www.camera.it/application/xmanager/projects/leg18/attachments/conoscerelacamera/upload\\_files/000/000/336/original\\_codice\\_condotta\\_deputati.pdf](https://www.camera.it/application/xmanager/projects/leg18/attachments/conoscerelacamera/upload_files/000/000/336/original_codice_condotta_deputati.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 14.09.2023).

<sup>105</sup> Shih: Kodi i sjelljes së anëtarit të PE-së në lidhje me interesat financiare dhe konfliktin e interesit në linkun

[https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305\\_Code\\_of\\_conduct\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/pdf/meps/201305_Code_of_conduct_EN.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 14.09.2023).

<sup>106</sup> Shih: Kodi i Sjelljes Etike të Deputetit, në linkun <https://www.sobranie.mk/kodi.nsp.x> (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>107</sup> Shih: Kodi i Sjelljes, House of Commons, UK në linkun <https://publications.parliament.uk/pa/cm5803/cmcode/1083/1083.pdf> (Aksesuar për herë të fundit më 14.09.2023).

<sup>108</sup> Shih: Committee on Ethics në linkun <https://ethics.house.gov/> (Aksesuar për herë të fundit më 23.09.2023).

<sup>109</sup> Neni 31 - KSDKRSH

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

disiplinore<sup>110</sup> të marra ndaj tyre, kompetencë e cila ka gjetur parashikim në kuadër të rekomandimeve të mekanizmave ndërkombëtarë monitorues për krijimin e mekanizmit të ankimit ndaj masave disiplinore, që mund t'i jepen deputetit, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me procesin e rregullt ligjor<sup>111</sup>.

## Byroja shqyrton çështjen duke mbajtur parasysh tri elemente thelbësore<sup>112</sup>:

- Të drejtën e subjektit për të paraqitur ankesë për sjelljen e një ose më shumë deputetëve;
- Zhvillimin e një hetimi për të vërtetuar faktet dhe për të mundësuar një vendim nëse rregullat apo normat janë shkelur; dhe
- Dhënien e sanksioneve përkatëse aty ku konstatohet se ka ndodhur sjellja e pahijshme.

Referuar praktikave të mira parlamentare organi përgjegjës për zbatimin e rregullave të sjelljes harton raport vjetor për zbatimin e tyre. Në pajtueshmëri me këto standarde edhe Kodi i Sjelljes parashikon përgatitjen e raporteve vjetore, megjithëse kjo dispozitë nuk ka gjetur zbatim.

Zbatimi i rregullave mbi të gjitha kërkon një vullnet të madh politik. Ndërkohë që Kodet e Etikës bazohen në standardet e një sjelljeje tashmë të pranuar nga vetë parlamentarët, duhet gjithashtu të parashikohet vendosja e standardeve të reja duke i shërbyer promovimit të vazhdueshëm të integritetit dhe transparencës<sup>113</sup>. Për këtë arsye, është i nevojshëm vlerësimi periodik i zbatimit të kodit dhe rishikimi i tij. Organizma ndërkombëtarë u rekomandojnë parlamenteve *publikimin e një raporti që përfshin të gjitha ankesat dhe raportimet për shkeljen e rregullave të Kodit duke vënë në dukje gjithashtu trajtimin e tyre*<sup>114</sup>. *Përpilimi i këtyre raporteve është i dobishëm në dhënien e informacionit rreth nevojës për të rishikuar dhe përditësuar Kodin e Sjelljes si dhe në reagimet e publikut dhe shoqërisë civile. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në vitet e para pas miratimit të Kodit, që të mund të "rishikohet në dritën e çdo ndryshimi që mund të ndodhë"*<sup>115</sup>.

<sup>110</sup> Referuar nenit 63, pika 2 dhe 3 të Rregullores së Kuvendit masa të rënda disiplinore janë: përjashtim nga seanca plenare dhe përjashtim nga pjesëmarrja në seancë plenare/ komisione/organet e Kuvendit deri në 10 ditë. Masat disiplinore të lehta nuk ankimohen.

<sup>111</sup> Neni 11/3 Rregullore Kuvendi.

<sup>112</sup> Pika 29- Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend miratuar me vendim nr. 19/2018 të Byrosë së Kuvendit.

<sup>113</sup> Shih: Handbook on parliamentary ethics and conduct a guide for parliamentarians, WDF & GOPAC

[https://gpgovernance.net/wp-content/uploads/2021/02/HandbookonParliamentaryEthicsandConductFinal2010\\_EN-1.pdf](https://gpgovernance.net/wp-content/uploads/2021/02/HandbookonParliamentaryEthicsandConductFinal2010_EN-1.pdf) fq. 10 (Aksesuar për herë të fundit më 13.09.2023).

<sup>114</sup> Shih: Commonwealth AntiCorruption Benchmarks, (Commonwealth Secretariat) 2021 fq. 46-48 cit. në linkun

[https://production-new-commonwealth-files.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/2022-04/Anti-Corruption%20Benchmarks\\_UPDF.pdf?VersionId=mDx64yykQWIJ\\_T.Xhdk0nEtyf\\_NH\\_n4b](https://production-new-commonwealth-files.s3.eu-west-2.amazonaws.com/s3fs-public/2022-04/Anti-Corruption%20Benchmarks_UPDF.pdf?VersionId=mDx64yykQWIJ_T.Xhdk0nEtyf_NH_n4b) (Aksesuar për herë të fundit më 15.09.2023).

<sup>115</sup> Shih: Implementing codes of conduct in public institutions, fq. 5. Transparency International (2014) në linkun

[https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/helpdesk/Implementing\\_codes\\_of\\_conduct\\_in\\_public\\_institutions\\_2014.pdf](https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/helpdesk/Implementing_codes_of_conduct_in_public_institutions_2014.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 15.09.2023).

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

Në pajtueshmëri me këtë rekomandim edhe Kodi i Sjelljes parashikon hartimin e një raporti vlerësues. Transparenca në procedurat e zbatimit të Kodit është një indikator i efektivitetit të kodeve të sjelljes, pasi tregon në detaje shkeljen e parlamentarit dhe sanksionin e aplikuar. Kjo transparencë rrit besimin e publikut tek parlamenti dhe promovon kulturën e llogaridhënies. Që prej miratimit të Kodit të Sjelljes në vitin 2018, nuk është publikuar asnjë raport vlerësues ose të dhëna për zbatimin e tij, rrjedhimisht rëndësia e këtij akti në parandalimin ose uljen e korrupsionit në vend nuk është dokumentuar ende.

Përmes mekanizmit të monitorimit edhe qytetarët, mediat, nëpunësit apo publiku i gjerë, të cilit parlamentarët i shërbejnë, do të mund të zhvillojnë debat për sjelljen e pranueshme të tyre, të shprehin shqetësimet e tyre dhe të paraqesin parregullsitë në punën e tyre. Në këtë kontekst, Kuvendi duhet të mundësojë në mënyrë aktive monitorimin dhe raportimin nga OSHC-të të respektimit të standardeve etike dhe të sjelljes të vendosura në Kodin e Sjelljes.

Në praktikat e mira parlamentare kodet e sjelljes i nënshtrohen vlerësimit periodik në fund të çdo legjislature<sup>116</sup>.

---

<sup>116</sup> P.sh. në Mbretërinë e Bashkuar vlerësimi i standardeve etike dhe të sjelljes bëhet nga Komisioni për Standardet në Jetën Publike. Shih: Upholding Standards in Public Life, The Committee on Standards in Public Life, 2021 në linkun [https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment\\_data/file/1029944/Upholding\\_Standards\\_in\\_Public\\_Life\\_-\\_Web\\_Accessible.pdf](https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/1029944/Upholding_Standards_in_Public_Life_-_Web_Accessible.pdf) (Aksesuar për herë të fundit më 22.09.2023).



## ANEKS INFORMUES

Instituti i Studimeve Politike ka përvojë të gjatë në monitorimin e parlamentit dhe të aktivitetit parlamentar, përfshirë edhe të standardeve të jetësimit të Kodit të Sjelljes. ISP ka hartuar dhe publikuar raporte publike, si dhe ka ofruar për deputetët e rinj broshura informative mbi përgjegjësitë parlamentare, funksionet e deputetit dhe standardet e integritetit. Disa nga dokumentet më të rëndësishme të ISP-së në këtë fushë mund të gjenden online në adresat e mëposhtme:

1. *Vlerësimi i kapaciteteve dhe mekanizmit monitorues në Kuvend (2023)*  
<https://isp.com.al/wp-content/uploads/2023/09/ISP-Vleresimi-i-kapaciteteve-dhe-mekanizmit-raportues-ne-Kuvend-permbledhje.pdf>
2. *Broshurë informative mbi deputetë dhe aktivitetin parlamentar (2021)*  
<https://isp.com.al/brochure-informative-per-deputetet-kuvendin-dhe-aktivitetin-parlamentar/>
3. *Broshurë për deputetët mbi konfliktin e interesit dhe Kodin e Sjelljes (2019)*  
<https://isp.com.al/isp-brochure-per-deputetet-mbi-konfliktin-e-interesit-dhe-kodin-e-sjelljes/>
4. *Perceptimi qytetar mbi parlamentin dhe deputetët (2023)*  
<https://isp.com.al/wp-content/uploads/2023/04/ISP-Anketim-me-qytetaret-per-parlamenti-2023.pdf>
5. *Impakti i mungesës së akteve nënligjore: përvoja dhe perspektiva në Shqipëri (2020)*  
<https://isp.com.al/wp-content/uploads/2020/09/ISP-Impakti-i-mungeses-se-akteve-nenligjore-raport-teknik-shtator-2020-3.pdf>
6. *Perceptimi qytetar mbi deputetët dhe parlamentin (2020)*
7. <https://isp.com.al/isp-perceptimi-qytetar-mbi-deputetet-dhe-parlamentin-anketim-2020-2/>
8. *Anketim me gratë deputete: roli, modele dhe sfida të përfaqësimit (2019)*  
<https://isp.com.al/anketim-me-grate-deputete-rolin-modele-dhe-sfida-te-perfaqesimit/>
9. *Anketim me deputetët: Mbi zgjedhësit, Kuvendin, ligjet dhe sfidat*  
<https://isp.com.al/anketimi-me-deputetet-vleresimi-mbi-zgjedhësit-kuvendin-ligjet-funksionin-e-sfidat/>
10. *Roli i parlamentit në procesin e integritetit (2022)*  
<https://isp.com.al/policy-paper-the-role-of-the-parliament-in-albanias-eu-integration-process/>
11. *Kuvendi dhe deputetët: roli kushtetues dhe Kodi i Sjelljes (2023)*  
<https://isp.com.al/wp-content/uploads/2023/01/ISP-KUVENDI-DHE-DEPUTETET-RAPORT-2023.pdf>
12. *Raport IV mbi zbatimin e Kodit të Sjelljes në parlament (2020)*  
<https://isp.com.al/isp-the-fourth-report-on-the-conflict-of-interest-the-code-of-ethics-2020/>
13. *Raport III mbi zbatimin e Kodit të Sjelljes në parlament (2019)*  
<https://isp.com.al/isp-raport-mbi-konfliktin-e-interesit-dhe-respektimin-e-kodit-te-sjelljes-ne-aktivitetin-parlamentar-shtator-dhjetor-2019/>
14. *Raport II mbi zbatimin e Kodit të Sjelljes në parlament (2019)*  
<https://isp.com.al/isp-raport-i-dyte-mbi-konfliktin-e-interesit-dhe-respektimin-e-kodit-te-sjelljes-ne-aktivitetin-parlamentar/>
15. *Raport I mbi zbatimin e Kodit të Sjelljes në parlament (2019)*  
<https://isp.com.al/isp-raport-mbi-konfliktin-e-interesit-dhe-respektimin-e-kodit-te-sjelljes-ne-kuvend/>
16. *Raport i monitorimit të Kuvendit (II - 2022)*  
<https://isp.com.al/wp-content/uploads/2023/01/ISP-KUVENDI-DHE-DEPUTETET-RAPORT-2023.pdf>
17. *Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2022)*  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2022/09/ISP-Aktiviteti-parlamentar-dhe-cilesia-e-perfaqesimit-raport-II-2022-3.pdf>
18. *Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2021)*  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2021/09/ISP-PARLAMENTI-GJATE-PERIUDHES-SE-COVID-19.pdf>
19. *Raport i monitorimit të Kuvendit (II - 2021)*  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2022/06/ISP-Deputetet-Kuvendi-dhe-aktiviteti-parlamentar-I-2022.pdf>

# KODI I SJELLJES, PRAKTIKAT, MODELET DHE STANDARDET E INTEGRITETIT PARLAMENTAR

20. Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2020)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2021/09/RAPORT-9-PARLAMENTI-NE-KOHEN-E-PANDEMISE-BILANCI-DHE-PROBLEMATIKA-JANAR-KORRIK-2020.pdf>
21. Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2019)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2019/09/RAPORT-7-MONITORIMI-I-KUVENDIT-JANAR-KORRIK-2019.pdf>
22. Raport i monitorimit të Kuvendit (II - 2019)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2020/02/ISP-RAPORTI-I-MONITORIMI-TE-KUVENDIT-Shtator-Dhjetor-2019.pdf>
23. Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2018)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2018/08/ISP-PARLAMENTI-NE-PASQYRE-RAPORT-MONITORIMI-JANAR-KORRIK-2018.pdf>
24. Raport i monitorimit të Kuvendit (II - 2018)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2019/02/ISP-RAPORT-MONITORIMI-TE-KUVENDIT-SHTATOR-DHJETOR-2018-FINAL.pdf>
25. Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2017)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2017/10/RAPORT-3-MONITORIMI-I-KUVENDIT-JANAR-KORRIK-2017-1.pdf>
26. Raport i monitorimit të Kuvendit (II - 2017)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2018/01/RAPORTI-I-PARE-MBI-KUVENDIN-2018-1.pdf>
27. Raport i monitorimit të Kuvendit (I - 2016)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2017/10/RAPORT-1-MONITORIMI-I-KUVENDIT-JANAR-KORRIK-2016.pdf>
28. Raport i monitorimit të Kuvendit (II - 2016)  
<https://deputetim.al/wp-content/uploads/2017/10/RAPORT-2-MONITORIMI-I-KUVENDIT-SHTATOR-DHJETOR-2016.pdf>

DEPUTETIM.al

Parlamenti im    Deputeti im

Studime dhe Raporte    Pyet Deputetin

Gjithcka Mbi Ligjet    Seancat Plenare

Komisionet Parlamentare    Transparenca financiare

Gratë Deputete    Grupet Parlamentare

Home    Gjetjet    Kontakto

ISP  
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES

KINGDOM OF THE NETHERLANDS

Deputeti im

Shkarko Aplikacionin...

Get it on Google play

Available on the App Store





